

TAP

Trans Adriatic Pipeline



VNMS Shqipëri Aneksi 11.4 – Kriteret e Ndjeshmërisë

 	Faqe 2 nga 8				
	Kodi i Zonës	Kodi i Kompjuterit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disk.	Lloji i Dokumentit
Titulli i Projektit: Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP Titulli i Dokumentit: Aneksi 11.4 – Kriteret e Ndjeshmërisë	AAL00-ERM-641-Y-TAE-1010 Rish.: 00 / at11				

PËRMBAJTJA

1	KRITERET E NDJESHMËRISË	3
1.1	Habitatet	3
1.2	Speciet	4

LISTA E TABELAVE

Tabela 1-1	Kriteret e ndjeshmërisë/vulnerabilitetit të habitatit.....	3
Tabela 1-2	Kriteret e ndjeshmërisë / vulnerabilitetit të specieve	4
Tabela 1-3	Kategoritë e Listës së Kuqe të UNRN-së	5

LISTA E KUADRATEVE

Kuadrati 1-1	Kriteret e magnitudës	8
--------------	-----------------------------	---

 	Faqe 3 nga 8					
	Kodi i Zonës	Kodi i Kompju-terit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disk.	Lloji i Doku-mentit	Nr. i Serisë
Titulli i Projektit	Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP					AAL00-ERM-641-Y-TAE-1010 Rish.: 00 / at11
Titulli i Dokumentit:	Aneksi 11.4 – Kriteret e Ndjeshmërisë					

1 KRITERET E NDJESHMËRISË

1.1 Habitatet

Tabela 1-1 Kriteret e ndjeshmërisë/vulnerabilitetit të habitatit

Kriteri

Statusi i Ruajtjes/Konservimit dhe i Zonës së Përcaktuar

1. Status i Përcaktuar

Katalogimi i habitatit brenda anekseve të Direktivës për Habitatet ose nën Konventën e Bernës.

Habitatet me Prioritet për BE-në– Habitatet e katalogizuara sipas Aneksit I të Direktivës për Habitatet dhe për të cilat vendet brenda BE-së duhet të përcaktojnë domosdo zonat kyçe;

Habitatet e Konventës së Bernës– Habitatet e katalogizuara si prioritare sipas Konventës së Bernës dhe që janë të pranishme në Shqipëri;

Habitatet Evropiane – Habitatet që janë joprioritare, por që hasen brenda Evropës dhe katalogizohen në Manualin për Interpretim të Habitatëve të BE-së (2007) dhe janë me origjinë natyrore ose gjysmë-natyrore;

Struktura dhe Funkzioni i Ekosistemit

2. Natyrshmëria

Duhet të vlerësohet natyrshmëria e habitatit. Mjediset e modifikuara janë mjedise në të cilat aktiviteti i njeriut ka modifikuar funksionet kryesore ekologjike të zonës, ta zëmë, nëpërmjet peshkimit apo inkuadrimit të specieve të huaja.

Shënim: Kjo përcakton shkallën në të cilën habitatit është 'i natyrshëm' apo 'i modifikuar', në përputhje me PR6 të BERZH-it (Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, angl. EBRD).

3. Brishtësia

Duhet të vlerësohet patjetër brishtësia dhe ndjeshmëria e habitatit dhe aftësia e tij për ta rimarrë veten (qoftë natyrshëm, qoftë me ndihmë) nga trazimi, duke përfshirë invazionin nga specie të huaja.

4. Përfaqësueshmëria

Shkalla në të cilën habitatit konsiderohet të jetë shembull i shkëlqyeshëm i llojeve të rëndësishme natyrore apo gjysmë natyrore të vegjetacionit për sa u përket bashkësive të florës (dhe faunës së ndërlidhur me to) që përmban ai.

5. Struktura dhe Funkzioni

Shkalla në të cilën habitatit ofron një strukturë të rëndësishme apo i shërben një funksioni të rëndësishëm. Kjo përfshin:

pasjen e një korridorit ekologjik ndërmjet habitateve të tjera të izoluara me rëndësi ekologjike;

rëndësinë në kontekstin e shtegtimeve të faunës; apo

rëndësinë në kontekst të cikleve jetësore (shumim, fidanishte, apo terrene për ushqim).

6. Shoqata e Specieve – Mbështetja

Shkalla në të cilën habitatit përmban apo në të cilin mbështeten përqendrimet e specieve që janë:

gamë endemike apo e kufizuar;

të rralla në rrafsh kombëtar apo lokal (veçanërisht specie të Librit të Kuq, apo ato që mbrohen simbas legjislacionit kombëtar apo ndërkombëtar, apo katalogizohen nga Unioni Ndërkombëtar për Ruajtje të Natyrës (UNRN) [angl. International Union for Conservation of Nature, IUCN] (shih *Tabelën 1-2* për speciet);

specie kyçe, në të cilat mund të mbështeten speciet e tjera për mbijetesë;

duke pësuar reduktim serioz në rrafsh kombëtar ose lokal;

në skaje të gamës së tyre;

të pranishme në popullata bukur të mëdha;

tubime unike të specieve që ndërlidhen me procese kyçe evolucionare; apo

të pazakonta/të rralla apo të kërcënuara në një kontekst më të gjerë.

Po qe se speciet janë vlerësuar nga UNRN, duhet të aplikohen rangimet si në vijim (shih *Tabelën 2* për speciet)

Për Florën (Vangjeli et al., 1995) dhe Faunën (REC, 1997; Misja, 2006) Librat e Kuq përkatës të Shqipërisë janë marrë si referencë për specie me status Kombëtar.

7. Diversiteti

Diversiteti i habitateve dhe diversiteti dhe pasuria e specieve të tyre individuale (duke përfshirë diversitetin e tyre gjenetik) janë të rëndësishme. Në përgjithësi, sa më i madh numri i përgjithshëm i specieve të regjistruara, aq më i madh interesi për ruajtje/konservim të zonës.

 	Façe 4 nga 8					
	Kodi i Zonës	Kodi i Kompjuterit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disk.	Lloji i Dokumentit	Nr. i Serisë
Titulli i Projektit	Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP					AAL00-ERM-641-Y-TAE-1010 Rish.: 00 / at11
Titulli i Dokumentit:	Aneksi 11.4 – Kriteret e Ndjeshmërisë					

1.2 Speciet

Rëndësia e specieve vlerësohet sipas kriterëve të pranuar, si rrallësia dhe shkalla e kërcënimit që kanë. Rëndësia e specieve për bashkësitë më të gjera ekologjike dhe për ekosistemin (*p.sh.* relacionet grabitqar/pre) merret po ashtu parasysh, si edhe shkalla e mbrojtjes së specieve me legjislacion shqiptar dhe ndërkombëtar. *Tabela 1-2* paraqet disa kriteret për të vendosur për rëndësinë e rasteve individuale. Është përdorur kategorizimi sipas UNRN-së në nivel global dhe kombëtar për të identifikuar speciet me prioritet, kur ka qenë me vend. Për referencë ndaj statusit të specieve sipas UNRN-së shih *Tabelën 1-3*.

Kur kishte në dispozicion Lista të Kuqe Mesdhetare të UNRN-së për peshqit (Smith, *et al.*, 2006), gjitarët (Temple dhe Cuttelod, 2009), amfibet dhe rrëshqanorët (Cox, *et al.*, 2006), janë përdorur këto kategori të Listave të Kuqe, sepse japin shumë më shumë hollësi specifike për shkallën e rrezikut ndaj specieve në Mesdhe dhe në Evropë. Ligji shqiptar i pranon plotësisht kategoritë e kërcënimit të UNRN-së, që pasqyrohen në Librin e Kuq të të Dhënave për kafshët (REC, 1997; Misja, 2006) dhe për speciet e bimëve (Vangjeli, *et al.*, 1995).

Tabela 1-2 Kriteret e ndjeshmërisë / vulnerabilitetit të specieve

Rëndësia:	E ulët	Mesatare	E lartë
<i>Kriteret</i>			
Statusi i mbrojtjes	Nuk mbrohet as katalogizohet. Speciet e future/inkuadruara ose të huaja.	<ul style="list-style-type: none"> Kategorizohet si Vulnerable (VU), e Varur nga Ruajtja/Konservimi (VR) [angl. Conservation Dependant, CD), Gati e Kërcënuar (GK) [Near Threatened, NT) ose Brenga më e Vogël (BV) [Least Concern, LC] në Listën e Kuqe Globale të UNRN-së. Speciet e Mbrojtura në nivel Kombëtar; Specie e Aneksit III, kategorizuar në Konventën e Bernës; Kategorizuar si VU, GL, BV, në Librin e Kuq të të Dhënave të Shqipërisë; Speciet qoftë të katalogizuara si Pa të Dhëna (PDH) [Data Deficient, DD), qoftë Të Pavlerësuar (PV) [Not Evaluated, NE) në nivel global ose kombëtar, për të cilat mund të nevojitet ruajtja/konservimi. 	<ul style="list-style-type: none"> Kategorizohet si e Rrezikuar Rëndë (RrR) [angl. Critically Endangered, CR)] ose e Rrezikuar (RR) [Endangered, EN) qoftë në listën Globale të UNRN-së, qoftë në Listën e Kuqe Kombëtare; Specie në rënie në numër kategorizuar si VU, apo më poshtë në Librin e Kuq të të Dhënave të Shqipërisë. Kategorizuar nga UNRN si e Rrallë, e Kërcënuar apo e Rrezikuar. Specie të Aneksit I, II që katalogizohen në Konventën e Bernës; Specie të Aneksit II, IV që katalogizohen në Direktivën e Habitave të BE-së; Specie të Aneksit I që katalogizohen në Direktivën për Zogjtë.

 		Faqe 5 nga 8					
		Kodi i Zonës	Kodi i Kompju-terit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disk.	Lloji i Doku-mentit	Nr. i Serisë
Titulli i Projektit	Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP					AAL00-ERM-641-Y-TAE-1010	
Titulli i Dokumentit:	Aneksi 11.4 – Kriteret e Ndjeshmërisë					Rish.: 00 / at11	

Rëndësia:	E ulët	Mesatare	E lartë
Statusi i ruajtjes/konservimit	Përhapur / me bollëk	<ul style="list-style-type: none"> Specie e përhapur globalisht por e rrallë në Shqipëri. E rrallë ose popullatë në rënie. Nëpopullatë endemike në rrafsh lokal ose të veçanta në rrafsh lokal. Në kufijtë e gamës së saj. Specie që i nënshtrohen programit të menaxhimit aktiv. Grupe që kanë qenë ose i janë nënshtuar studimit aktiv shkencor. 	<ul style="list-style-type: none"> Mbrojtur si më lart.
Diversiteti gjenetik	Diversiteti i Lartë Gjenetik, mbasi që janë të shumta në numër, me popullatë shumë të ndërlidhura.	<ul style="list-style-type: none"> Një specie që ka ndërlidhshmëri të kufizuar ndërmjet popullatave; Një specie që ka vetëm një madhësi mesatare ose të vogël të popullatës; Speciet me pjellori të ulët. 	<ul style="list-style-type: none"> Specie me ndërlidhshmëri të kufizuar apo pa ndërlidhshmëri ndërmjet popullatave; Popullatat janë në numër të vogël; Një specie ka pjellori shumë të ulët dhe prodhon numër minimal të të rinjve që mbeten të varura për një sere vitesh.
Funksionimi i Ekosistemit:	Jo me rëndësi vendimtare për funksionet e ekosistemit.	Një nga disa speciet luan rol në funksionet e ekosistemit.	Me rëndësi vendimtare (specie kyçe (1) apo inxhinier i ekosistemit (2) për funksionet e ekosistemit.

Shënim:

- (1) Specie kyçe është ajo specie që luan rol me rëndësi vendimtare për të mbajtur strukturën e një bashkësie ekologjike dhe ndikim i së cilës në bashkësi është më i madh se që do të pritej bazuar në bollëkun e saj relativ apo në biomasën e gjithëmbarshme.
- (2) Një specie që modifikon disponueshmërinë e burimit për pjesëtarë të tjerë të bashkësisë nëpërmjet modifikimit të habitatit.

Tabela 1-3 Kategoritë e Listës së Kuqe të UNRN-së

Lista e Specieve të Kërcënuara (Lista e Kuqe e UNRN-së) e Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen/Konservimin e Natyrës (UNRN) [angl. The International Union for the Conservation of Nature, IUCN] është një qasje globale, e njohur gjerësisht, për vlerësimin e statusit të ruajtjes/konservimit të specieve të bimëve dhe të kafshëve. Ajo jep informacion taksomik për shpërndarjen dhe statusin e ruajtjes/konservimit mbi taksat (angl. taxa, nga takson) që përballen me rrezik të madh të zhdukjes globale. Speciet kategorizohen si:

- * E Rrezikuar Rëndë (**RrR**): Një takson (taxon) është i/e Rrezikuar Rëndë kur konsiderohet se përballen me një rrezik jashtëzakonisht të lartë të zhdukjes në natyrë të egër;
- *E Rrezikuar (**RR**): Një takson është i/e Rrezikuar kur konsiderohet se përballen me rrezik shumë të lartë të zhdukjes në natyrë të egër;
- *Vulnerabël (**VU**): Një takson është Vulnerabël kur konsiderohet se përballen me rrezik të lartë të zhdukjes në natyrë të egër;
- Gati e Kërcënuar (**GK**): Një takson është Gati i/e Kërcënuar kur është vlerësuar me kriteret por nuk kualifikohet hëpërhë për të Rrezikuar Rëndë, Të Rrezikuar apo Vulnerabël, por është afër kualifikimit ose ka gjasë të kualifikohet në kategorinë e kërcënuar në të ardhme të afërt;
- Brengë e Vogël (**BV**) (**angl. Least Concern, LC**): Një takson është Brengë e Vogël kur është vlerësuar me kriteret dhe nuk kualifikohet për kategoritë më të larta. Taksat e përhapura dhe me bollëk përfshihen në këtë kategori. U referohen po ashtu edhe si me Rrezik të Ulët (angl. **LR**);
- U referohet edhe kategorive të tjera, duke përfshirë E Varur nga Ruajtja/Konservimi (**VR**), Pa të Dhëna (**PDh**) dhe e Pavlerësuar (**PV**), ndonëse këto kategori nuk janë me rëndësi kyçe kur bëhen vlerësimet e specieve për këtë Projekt.

Shënim: Listat për nënkategoritë për RrR, RR dhe VU nuk janë të plota në këtë dokument, dhe për detaje të mëtejme duhet referuar Kategorive dhe Kriterëve të Listës së Kuqe të UNRN-së (Versioni 3.1) (UNRN, 2001). Të gjitha * statuset (RrR, RR, VU) grupohen si të Kërcënuara kur u referohemi specieve (siç janë dhënë për tabelat e Pasurisë së Specieve në Seksionin 6.7.1).

Burim:Kriteret dhe Kategoritë e Listës së Kuqe të UNRN-së (Versioni 3.1) (2001)

 	Faqe 6 nga 8					
	Kodi i Zonës	Kodi i Kompjuterit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disk.	Lloji i Dokumentit	Nr. i Serisë
Titulli i Projektit	Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP					AAL00-ERM-641-Y-TAE-1010 Rish.: 00 / at11
Titulli i Dokumentit:	Aneksi 11.4 – Kriteret e Ndjeshmërisë					

Në disa raste statuset e kërcënimit të specieve janë të njëjta në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar, por në shumicën e rasteve statusi ndërkombëtar dhe kombëtar dallojnë nga njëri-tjetri.

Mbrojtja e specieve të faunës dhe florës së egër në Republikën e Shqipërisë rregullohet me një numër ligjesh, nënligjesh dhe rregulloresh, prej të cilave disa nga më të rëndësishmet janë:

- Ligji për Mbrojtjen e Biodiversitetit (nr. 9587, datë 20.07.2006);
- Ligji për Mbrojtjen e Faunës së Egër dhe Gjetinë (nr. 7875, i datës 23.11.1994) amandamentuar me Ligjin nr. 9219, i datës 08.04.2004, dhe
- Ligji nr. 9867, i datës 31.01.2008, “Mbi rregullat dhe procedurat për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Faunës dhe Florës së Egër”.

Si vend që synon të hyjë në BE dhe të respektojë rregulloret e BE-së për mjedisin, merret në shqyrtim rangimi në Konventën e Bernës i statusit të mbrojtjes evropiane të specieve të faunës së egër. Bazuar në filozofinë e Konventës, mbrojtja e biodiversitetit duhet të bazohet në 2 parime: (1) mbrojtja e specieve të shënjestruara të faunës dhe florës, dhe (2) mbrojtja e habitateve të plota. Bazuar në këtë qasje një sërë aneksesh janë integruar në Konventë:

- Aneksi 1: Speciet e florës të mbrojtura rreptësisht;
- Aneksi 2: Speciet e faunës të mbrojtura rreptësisht;
- Aneksi 3: Specie të mbrojtura të faunës (që mund të eksploatohen po qe se lejojnë nivelet e popullatës); dhe
- Aneksi 4: Mjetet dhe metodat e ndaluara të vrasjes/mbytyjes, zënies/kapjes dhe formave të tjera të eksploatimit.

Për këtë studim mbahet shënim kur speciet janë të katalogizuara në anekset e mësipërme të Konventës së Bernës.

Përveç kësaj, mbrojtja e specieve në lidhje me Direktivën për Habitatet (për gjitarët, rrëshqanorët, amfibet dhe jokërbisitorët) dhe në përputhje me Direktivën për Zogjtë (për speciet e zogjve) është lënë po ashtu në konsistencë me seksionet e tjera të trasesë së tubacionit që kalon nëpër Itali dhe Greqi.

Mbrojtja në përputhje me Direktivën për Habitatet është si më poshtë::

- Aneksi II: Speciet me interes për komunitetin, ruajtja/konservimi i të cilave kërkon përcaktimin e Zonave të Posaçme për Ruajtje/Konservim.
- Aneksi IV: Speciet me interes për komunitetin që kanë nevojë për mbrojtje të rreptë.
- Aneksi V: Speciet me interes, vendosja e të cilave në natyrë të egër dhe eksploatimi i tyre mund t'u nënshtrohen masave të menaxhimit.

 	Faqe 7 nga 8					
	Kodi i Zonës	Kodi i Kompjuterit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disk.	Lloji i Dokumentit	Nr. i Serisë
Titulli i Projektit Titulli i Dokumentit:	Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP Aneksi 11.4 – Kriteret e Ndjeshmërisë					AAL00-ERM-641-Y-TAE-1010 Rish.: 00 / at11

Nga këto, anekset II dhe IV janë kyçe për sa i përket mbrojtjes së specieve dhe vlerësimit të specieve në një kontekst evropian.

Mbrojtja në përputhje me Direktivën për Zogjtë është si më poshtë:

- Aneksi I: Zogjtë që u nënshtrohen masave të posaçme të ruajtjes në lidhje me habitatin e tyre për të siguruar mbijetesën dhe riprodhimin e tyre në zonën e tyre të përhapjes. Sipas nevojës, duhet të krijohen Zona të Posaçme të Ruajtjes për t'u ndihmuar masave të ruajtjes/konservimit.
- Aneksi IIa: Zogjtë mbi të cilët potencialisht mund të bëhet gjueti në përputhje me legjislacionin kombëtar brenda zonës gjeografike të tokës dhe detit, për të cilat vlen Direktiva.
- Aneksi IIb: Zogjtë mbi të cilët potencialisht mund të bëhet gjueti në përputhje me legjislacionin kombëtar vetëm brenda disa Vendeve Anëtare të specifikuar.

Prej këtyre, Aneksi I është kyç në lidhje me mbrojtjen e specieve dhe vlerësimin e rëndësisë së specieve në një kontekst evropian.

Thënë përmbledhtas, për speciet nga të gjitha kriteret vlerësuese të mësipërme si në mjedisin tokësor ashtu edhe ujor, dhe për vlerësim të ndikimeve të ardhme, speciet do të klasifikohen si:

- Specie me Prioritet të Lartë - Speciet e kategorizuara qoftë në rrafsh kombëtar qoftë ndërkombëtar sipas (të Rrezikuara Rëndë apo të Rrezikuara), në katalogun e Aneksit 1 apo 2 të Konventës së Bernës, ose në Direktivën për Habitatet (Aneksi II dhe IV) apo në Direktivën për Zogjtë (Aneksi I)
- Specie me Prioritet Mesatar – Speciet e kategorizuara si Vulnerable, të Varura nga Ruajtja/Konservimi, Gati të Kërcënuara, Brengë e Vogël apo Pa të Dhëna, apo të mbrojtura në rrafsh kombëtar, katalogizuar në Aneksin 3 të Konventës së Bernës, apo përmendur më lart në përputhje me çfarëdo mbrojtjeje kombëtare; dhe

Kriteret e Magnitudës për Speciet:

Magnituda e ndikimit është kombinim i disa faktorëve, duke përfshirë:

- Shtrirjen hapësinore gjatë së cilës përjetohet ndikimi;
- Shkalla në të cilën ndikohet në habitatin në të cilin mbështeten speciet (siç vlerësohet në rubrikën e 'Habitatëve' më lart);
- Popullata apo përpjesëtimi i saj që preket;
- Kohëzgjatja e ndikimit dhe/apo shkalla në të cilën përsëritet;
- Magnituda e aspektit (zhurma, drita, numri i lëvizjeve të automjeteve);
- Madhësia e gjurmës në kontekst të hapësirës më të gjerë në të cilën jeton një specie;

 	Faqe 8 nga 8					
	Kodi i Zonës	Kodi i Kompju-terit	Kodi i Sistemit	Kodi i Disk.	Lloji i Doku-mentit	Nr. i Serisë
Titulli i Projektit Titulli i Dokumentit:	Gazsjellësi Trans Adriatik – TAP Aneksi 11.4 – Kriteret e Ndjeshmërisë					AAL00-ERM-641-Y-TAE-1010 Rish.: 00 / at11

- Shkalla e ndryshimit të shkaktuar, p.sh. ndaj cilësisë së ujit; dhe
- Shkalla në të cilën një veçori e re fizike apo kimike inkuadrohet në mjedis, p.sh. madhësia e një strukture apo toksiciteti i një kimikateje.

Kriteret që janë përdorur për të vlerësuar magnitudën e ndikimeve ekologjike (bazuar në Duinker dhe Beanlands, 1986) paraqiten më poshtë.

Kuadrati 1-1 Kriteret e magnitudës

- Një **Ndikim i Magnitudës së Madhe** prek një popullatë të tërë apo specie në tërësi në magnitudë të mjaftueshme për të shkaktuar rënie të bollshme dhe/apo ndërrim në përndarje përtej të cilës rekrutim i natyrshëm (riprodhimi, imigrimi nga zonat e paprekura) nuk do t'i kthejë atë popullatë apo specie, apo ndonjë popullatë apo specie që varen prej saj, në gjendjen e dikurshme brenda disa brezash. Një ndikim i magnitudës së madhe ndaj një speciejë mundet po ashtu të prekë në mënyrë të pavolitshme integritetin e një vendndodhjeje, habitati apo ekosistemi. Një ndikim dytësor i magnitudës së madhe mund të prekë po ashtu përdorimin e burimeve komerciale apo të jetesës (p.sh. peshkoret) në shkallën që preket në afat të gjatë mirëqenia e përdoruesit.
- Një **Ndikim i Magnitudës së Mesme** prek një pjesë të popullatës dhe mund të sjellë ndryshim të bollshëm dhe/apo përndarje në një apo më shumë breza*, por nuk e kërcënon integritetin e asaj popullate apo të cilësdo popullatë që varet prej saj. Një ndikim i magnitudës së mesme mundet po ashtu të prekë funksionin ekologjik të një vendndodhjeje, habitat apo ekosistem, pa e prekur në mënyrë të pavolitshme integritetin e tij/saj të tërësishtëm. Shkalla e pasojës është po ashtu e rëndësishme. Një ndikim i magnitudës së mesme i shumëzuar në një zonë të gjerë do të konsiderohet si e madhe. Një efekt afatshkurtër në mirëqenien e përdoruesve të burimit mundet po ashtu të përbëjë ndikim të mesëm dytësor.
- Një **Ndikim i Magnitudës së Vogël** prek një grup specifik të individëve të lokalizuar brenda një popullate brenda një periudhe të shkurtër (një brez *¹ apo më pak), mirëpo nuk prek nivele të tjera trofike apo vetë popullatën.

¹ *Këta janë breza të specieveve/bimëve që janë në shqyrtim, dhe jo breza njerëzore.

Trans Adriatic Pipeline AG – Albania (Branch Office)
Torre Drin, Rruga Abdi Toptani
Tirana, Albania
Tel.: + 355 44 306 937
Fax: + 355 42 265 685
esia-comments@tap-ag.com
www.tap-ag.com

Data 01/2013

Copyright Rezervuara: Ky dokument nuk mund të kopjohet, treguar ose të vendosura në dispozicion të palëve të treta pa pëlqimin paraprak të TAP AG. Versioni i fundit i dokumentit është regjistruar në bazën e të dhënave Projekti TAP-së.

Copyright Reserved: This document may not be copied, shown to or placed at the disposal of third parties without prior consent of TAP AG. The latest version of the document is registered in the TAP Project's Database.